



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1000/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “CS” L.L.C, me seli në Fushë Kosovë, rruga “Hashim Hajdini”, kundër debitorit “Higjiena”. SH.A., me seli në Deçan, rruga “Bjeshkët e Deçanit”, përfaqësuar sipas autorizimit nga M.B., avokate nga Deçani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.163/23, të datës 14.06.2023, të Përmbaruesit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 21.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Higjiena” SH.A., i ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.163/23 të datës 14.06.2023, të Përmbaruesit Privat Eset Murati.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbarimor P.nr.163/23 i datës 14.06.2023, i Përmbaruesit Privat Eset Murati.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.163/23 të datës 14.06.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm- Faturës Nr.002-2022 të datës 20.10.2022, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 8,810.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e rënies në vonesë 06.11.2022 e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet përmbarimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.01/2022, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm, në të kundërtën realizimi i përmbarimit të bëhet përmes përmbarimit të mjeteve monetare në llogaritë bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat, regjistrimin, vlerësimin sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe përmbushjen e

kredisë së kreditorit nga shuma e fituar dhe shitja e atyre sendeve, në llogarinë e veçantë të përmbaruesit në TEB nr.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin e lejuar për përmbarim me arsyetimin se fatura në bazë të cilës është i lejuar urdhri për përmbarim është e paqartë, pasi që nuk jepet përshkrimi i shërbimeve që pala kreditore ka kryer për palën debitore. Më tutje ka shtuar se gjykata duhet të ketë parasysh se mbi çfarë pune juridike është bërë faturimi, ngase Kontrata për Shërbime e lidhur në mes të Shoqatës për Pastërti dhe Ambient Pamkos dhe NL Higjiena SH.A., të autorizuar si autoritet kontraktues nga Komuna e Deçanit dhe të përfaqësuar nga M.B.M., në njërën anë dhe ISD LLC, si operator ekonomik për kryerjen e shërbimeve në anën tjetër, bazë për këtë kontratë është Memorandumi Mirëkuptimit e lidhur ndërmjet Komunës së Deçanit dhe Ndërmarrjes Publike Lokale BPL “Higjiena”, SH.A dhe Pamkosit në anën tjetër, ku në nenin 7 të kësaj kontrate është paraparë se bazë e kësaj kontrate është Marrëveshja e Mirëkuptimi ndërmjet NL Higjiena SH.A., Pamkos, dhe Komuna e Deçanit, andaj ky nen drejton në këtë marrëveshje mirëkuptimi ku në nenin 4 të Memorandumit janë përcaktuar edhe kushtet e financimit dhe kontributet për realizimin e këtij projekti dhe në paragrafin 2 të këtij Memorandumi është përcaktuar se NLP Higjiena SH.A., do të alokoj mjetet financiare prej 3,000.00€ për implementimin e këtij projekti. Ka shtuar se mbi këtë bazë shihet se NLP Higjiena SH.A., dhe Pamkos ka qenë vetëm autoritete kontraktuese nga Komuna e Deçanit për të zhvilluar procedurat e tenderimit për projektet në fjalë, andaj mbi këtë bazë debitori nuk ka legjitimitet pasiv pasi që në këtë çështje, dhe ka përmbushur obligimin e saj të paraparë në memorandumit e mirëkuptimit pasi që ka alokuar 3,000.00€, dhe ka kryer obligimin ndaj operatorit ekonomik. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor P.nr.1638/23 i datës 14.06.2023, i Përmbaruesit Privat Eset Murati.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, duke theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit se i munguan legjitimiteti pasiv lidhur me këtë çështje, nuk qëndron për faktin se me debitorin është lidhur Kontrata për Shërbime me shenjën E003-08-21, fatura për shërbimet e kryera i është dorëzuar debitorit më datë 20.10.2022, i njëjti nuk e ka bërë denoncimin e faturës dhe për më tepër i është bërë kërkesë debitorit për shlyerjen e detyrimeve më datë 20.11.2022. Më tutje ka shtuar se shkaqet e prapësimit janë të parapara në nenin 71 të LPP-së dhe pasi që debitori në

prapësimin e ushtruar nuk ka ofruar kurrfarë prova me të cilat do ti mbështeste pretendimet e tij, i ka propozuar gjykatës të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbarim P.nr. 163/23 i datës 14.06.2023, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.002-2022 të datës 20.10.2022, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet edhe nga vula e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.002-2022 e datës 20.10.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1000/23, datë 21.09.2023

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.